

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Jonuz Bugari**, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Qmega**, në çështjen juridike të paditësit S. M. S. nga fshati O., Komuna e Rahovecit, kundër të paditurve S. M. S. dhe L. S. S. e lindur Sh. të dytë nga fshati O., Komuna e Rahovecit, për shkak të shuarjes së adoptimit, vlera e kontestit 200 euro, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe zbatimit të provave, më **27.03.2018** morri këtë:

A K T G J Y K I M

SHUHET adoptimi i adoptuesve **S. dhe L. S.**, me të adoptuarën **A. S.**, i themeluar me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Rahovec, Nd.nr.135/2008, i datës, 03.08.2009, të regjistruar në librat e amezës në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë, nr. rendor 1288, nr. i referencës 2/2006RL/2001.

Me shuarjen e adoptimit ndërprehen të gjitha të drejtat dhe obligimet e të adoptuarën me adoptuesit që i kanë takuar sipas dispozitave ligjore.

Ripërtrihen të gjitha të drejtat dhe obligimet e të adoptuarës **A. S.** me prindërit natyror – biologjik **S. dhe M. S.**, në harmoni me dispozitat e LFK-së.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi S. S., në këtë gjykatë kanë parashtruar padinë kundër të paditurve S. dhe L. S., për shkak të për shuarjes së adoptimit.

Në lidhje me këtë çështje juridike gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor për datën 27.03.2018. në të cilën seancë janë paraqitur paditësi personalisht, dhe të paditurit personalisht.

Paditësi deklaroi se ngel në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, përkundër fakti se është lidhur adoptimi ndërmjet adoptuesve S. dhe L. S. me fëmijën e tij A. S. nga viti 2009, nuk është realizuar praktikisht për shkak të rrethanave objektive, fëmiju ka vazhduar të jetoj me atë përkatësisht ai është përkujdesur për zhvillimin dhe edukimin e vajzës e cila në vazhdimësi ka qenë te ai, më vonë është rimartuar me A. S. dhe ka interes juridik që të shuhet adoptimi i lidhur me adoptimin paraprak, krejt këtë me marrëveshje të adoptuesit vëllaut të tij S. dhe bashkëshortes së vëllaut L., andaj i propozoi gjykatës që ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë, si të bazuar.

I padituri i parë S. S. deklaroi se i vërtetoi thëniet të cekura në padi si dhe thëniet e paditësit S. S. të cekura gjatë seancës. Duke shtuar se është e vërtetë edhe pse është themeluar adoptimi A. nuk ka vazhduar jetën me adoptuesit mirëpo ajo ka mbetur tek i ati i vetë jeton dhe më tutje, edhe për atë arsye nuk kundërshton që të bëhet anulimi i aktvendimit me të cilën është bërë adoptimi i saj.

E paditura e dytë L. S. deklaroi sikurse i padituri i parë, respektivisht nuk e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit dhe është e pajtimit që adoptimi i cili është kryer me aktvendimin e gjykatës i njëjti të anulohet, ngase prej momentit kur është bërë adoptimi vajza jeton me të atin e tij.

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, kjo gjykatë gjatë shqyrtimit gjyqësor pas dëgjimit të palëve, ka bërë edhe administrimin e provave si në vijim: ka bërë shikimin në aktvendimin e Gjykatës Komunale në Rahovec Nd.nr.135/2008, të datës 03.08.2009, ka bërë shikimin në certifikatën e martesës Nr.Sr. M ... e lëshuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec-Opterushë, më 05.01.2018, ka bërë shikimin në certifikatën e lindjes Nr. Sr. L ..., e lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Gjakovë, më 09.01.2018.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në dispozitat të neneve 7 dhe 8 të LPK-së, në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar dhe e njëjta është aprovuar.**

Me shikim në aktvendimin e Gjykatës Komunale në Rahovec, Nd.nr.135/2008, të datës 03.08.2009, është themeluar adoptimi nga qifti bashkëshortor, S. dhe L. S., i jo madhore A. S., e lindur më ..., nga i ati S. dhe të ëmës M. S..

Me shikimin e certifikatën e martesës Nr.Sr. M ..., e lëshuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec-Opterushë, më 05.01.2018, nga e cila vërtetohet se S. S. i lindur më ... dhe A. S. e lindur më ... kanë lidhur martesë më

Me shikimin në certifikatën e lindjes Nr. Sr. L ..., është vërtetuar fakti se A. S., është e lindur më ..., në Gjakovë, nga i ati S. S. dhe e ëma L. S..

Andaj në bazë të gjendjes faktike të lartcekurat, e duke u bazuar në nenet 198.1 të Ligjit për Familjen i Kosovës dhe nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, më datë 27.03.2018

**B. Profesional
Armond Qmega**

**Gjyqtari
Jonuz Bugari**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë–Divizioni Civil.